



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 354, Datë 01.12.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“DRINI BULQIZE” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “POLEMI”**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 01.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2417/1 prot., datë 24.11.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “POLEMI”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2417 prot., datë 17.11.2023, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e Përroit të Neshtës, Degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.
- Në formatin e aplikimit, shoqëria ka plotësuar kapacitetin e instaluar të HEC-it prej 2 MW, ndërsa në kontratën me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kapaciteti është 1.751 kW, ndaj nëse subjekti nuk dokumenton ndryshe, ERE në këtë procedurë do të marrë në konsideratë kapacitetin prej 1.751 kW, sipas Kontratës së nënshkruar me MIE-n.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”.

- Rezulton se janë depozituar në formatin fotokopje dokumentat e listuara në vijim, ndaj në zbatim të përcaktimeve të nenit 8, pika 3 të Rregullores, duhet të depozitohen në formatin origjinal/fotokopje e njësuar me origjinalin, dokumentet e mëposhtme:
 - Kontrata Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e HEC “Polemi”, e nënshkruar me MIE-n;
 - Shkresa dhe marrëveshja me OSSH sh.a. për miratimin në parim të pikës së lidhjes me sistemin e shpërndarjes;
 - Marrëveshja e nënshkruar me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Dibër;
 - VNM Paraprake.
- Po ashtu, nga ky aplikim rezulton se nevojitet të plotësohet dokumentacioni/informacion në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Të depozitohet vërtetimi i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për administratorin e saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”**: Të raportohet mbi vlerën e debisë së pashlyer ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Dibër, sipas Marrëveshjes për Pagesën me Këste të Detyrimeve Tatimore, të nënshkruar me këtë të fundit dhe në rast se është shlyer i tërë detyrimi, duhet të depozitohet vërtetimi që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve tatimore, ashtu edhe ndaj atyre të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores.
- **gërma “b” dhe “c”** Referuar deklaratës së shoqërisë se hidrocentrali është ndërtuar, duhet të depozitohet informacion mbi mënyrën e financimit të ndërtimit të tij.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “a”**: Saktësimet përkatëse në formatin e aplikimit sa i takon njësive gjeneruese dhe kapacitetit të secilës njësi, sipas përcaktimeve në kontratën me MIE-n, si dhe të plotësojë datën e fillimit të operimit.
- **gërma “d”**: Informacion mbi aplikimin për rinovimin e lejes për përdorimin e burimit ujor e nëse është pajisur me lejen e rinovuar, ta depozitojë atë në ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1,751 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI